



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 29 nëntor 2019
Nr. ref.: RK 1467/19

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI129/19

Parashtrues

Ramadan Koçinaj

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit
të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 78/2019, të 20 marsit 2019**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzie Istrefi Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar.

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Ramadan Koçinaj, me vendbanim në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), Rev. nr. 78/2019, të 20 marsit 2019, me të cilin ishte refuzuar si i pabazuar revizioni i tij kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit), Ac. nr. 3192/2016, të 15 nëntorit 2018. Aktgjykimin e kontestuar parashtruesi i kërkesës e kishte pranuar më 10 prill 2019.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është shqyrtimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet të jenë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës, të garantuara me nenet 23 [Dinjiteti i Njeriut], 24 [Barazia para Ligjit] dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).
4. Parashtruesi po ashtu kërkon që identiteti i tij të mos zbulohet publikisht.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullit 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 16 gusht 2019, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) e pranoi kërkesën e parashtruesit të cilën ai e kishte dorëzuar në postë më 10 gusht 2019.
7. Më 20 gusht 2019, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi në Gjykatë të njëjtën kërkesë që Gjykata e kishte pranuar më 16 gusht 2019, me sqarime dhe dokumente shtesë.
8. Në të njëjtën ditë, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Radomir Laban (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).
9. Më 28 gusht 2019, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës.
10. Në të njëjtën ditë, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore) ta dorëzojë fletëkthesën që dëshmon kohën kur parashtruesi i kërkesës e kishte pranuar vendimin e kontestuar.

11. Më 30 gusht 2019, Gjykata e pranoi nga Gjykata Themelore fletëkthesën e kërkuar.
12. Më 18 shtator 2019, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë një dokument "Kërkesë për shqyrtim urgjent" ku kërkoj, lidhur me rastin KI129/19, "shqyrtim të mirëfilltë ligjor, të drejtë, të paanshëm dhe me kohë".
13. Më 7 nëntor 2019, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

14. Kontesti për të cilin parashtruesi i kërkesës e ka paraqitur kërkesën në Gjykatë ka të bëjë me borxhin e faturuar nga Korporata Elektro-Energjetike e Kosovës (në tekstin e mëtejme: KEK) për banesën që gjendet në lagjen Bregu i Diellit në Prishtinë, me sipërfaqe 37 metër katrorë (në tekstin e mëtejme: banesa), të cilën parashtruesi i kërkesës në vitin 2009 e kishte blerë nga A. P.
15. Deri më 25 korrik 2005, njehsori elektrik në banesë ishte i regjistruar në emër të B. Z., i cili deri në atë kohë e kishte në shfrytëzim banesën.
16. Më 25 korrik 2005, KEK kishte nënshkruar kontratë për shërbimet e energjisë elektrike me konsumatoren S. XH. F. me shifër DPR-90033092 dhe numër njehsori 11727231.
17. Më 7 mars 2006, KEK kishte vendosur në banesë njehsorin e ri me nr. 202278, pasi njehsori i vjetër nuk ishte prezantuar.
18. Më 21 korrik 2009, parashtruesi i kërkesës e kishte blerë banesën nga A. P.
19. Më 4 gusht 2009, parashtruesi i kërkesës kishte lidhur kontratë të qirasë me N. B., dhe me rastin e lidhjes së kontratës kishte marrë nga N. B. një shumë të caktuar parash, si paradhënie.
20. Më 17 nëntor 2009, KEK kishte vendosur në banesë njehsorin e ri me nr. 92344752, pasi njehsori i vjetër nuk ishte prezantuar.
21. Më 2 dhjetor 2009, parashtruesi i kërkesës kishte bërë kërkesë në KEK për shlyerje të borxhit të akumuluar nga shfrytëzuesit e mëhershëm të banesës, për njehsorin e energjisë elektrike që ishte në emër të S. XH. F., pasi konsideronte se ai nuk ishte përgjegjës për të paguar atë borxh.
22. Më 23 maj 2011, parashtruesi i kërkesës kishte lidhur kontratë me A. R. për shitjen e shtëpisë me ngastër kadastrale P-71914059-06725-0, në Zonën Kadastrale Prishtinë (në tekstin e mëtejme: shtëpia), në një shumë të caktuar parash.
23. Më 11 nëntor 2011, parashtruesi i kërkesës kishte lidhur kontratë me S. K. për shitjen e banesës, në një shumë të caktuar parash.

24. Më 20 gusht 2012, Departamenti për Konsumator i KEK-ut kishte refuzuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës për shlyerje të borxhit të akumuluar nga shfrytëzuesit e mëhershëm të banesës.
25. Më 4 korrik 2012, parashtruesi i kërkesës ndaj përgjigjes së Departamentit për Konsumator të KEK-ut, kishte paraqitur ankesë në Departamentin për Mbrojtje të Konsumatorit të Zyrës Rregullative për Energji (në tekstin e mëtejme: ZRRE).
26. Më 27 gusht 2012, ZRRE, përmes Vendimit ZRRE/DMK_V_847_08_12, miratoi ankesën e parashtruesit të kërkesës mbi kontestimin e borxhit deri në korrik 2009, duke obliguar KEK-un që borxhin e akumuluar deri më 19 janar 2005 ta kërkoj përmes Gjykatës kompetente nga B. K., ndërsa borxhin e akumuluar nga periudha 25 korrik 2005 deri në korrik 2009, ta kërkoj përmes Gjykatës kompetente nga S. XH. F.
27. Në një datë të pasaktësuar, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur padi kundër KEK-ut në Gjykatën Themelore duke kërkuar kompensimin e dëmit material dhe jomaterial (fitimin e humbur për shitje nën çmimin real të banesës dhe të shtëpisë; mosrealizimit të qirasë për banesë; kompensim për zvogëlim të aktivitetit jetësor). Parashtruesi i kërkesës pretendonte se si rezultat i mosfurnizimit – shkyçjes së energjisë elektrike nga KEK-u dhe duke e mbajtur nën presion parashtruesin për borxhin që është shpenzuar nga personat e tjerë, para korrikut 2009, të vërtetuar me vendimin e lartcekur të ZRRE-së, KEK-u i ka shkaktuar atij dëmet e lartcekura për të cilat kërkonte kompensim.
28. Më 7 prill 2016, Gjykata Themelore, përmes Aktgjykimit C. nr. 2437/12, refuzoi si të pabazuar padinë e parashtruesit të kërkesës, duke arsyetuar, mes tjerash, se në vitin 2009, banesa ishte duke u furnizuar me energji elektrike por KEK-u kishte ndërprerë energjinë elektrike në banesë për shkak të borxheve të papaguara nga parashtruesi i kërkesës për kohën pas korrikut 2009, kur ai kishte në shfrytëzim banesën.
29. Parashtruesi i kërkesës u ankua kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore [C. nr. 2437/12], në Gjykatën e Apelit, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
30. Më 15 nëntor 2018, Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit AC. nr. 3192/2016, e refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore [C. nr. 2437/12].
31. Parashtruesi i kërkesës parashtroi revizion në Gjykatën Supreme, kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit [AC. nr. 3192/2016], për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

32. Më 20 mars 2019, Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit Rev. nr. 78/2019, refuzoi si të pabazuar revizionin e parashtruesit të kërkesës, kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit [AC. nr. 3192/2016].

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

33. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimin e kontestuar, Gjykata Supreme ka bërë shkelje të të drejtave të tij të garantuara me nenet 23 [Dinjiteti i Njeriut], 24 [Barazia para Ligjit] dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.
34. Parashtruesi i kërkesës pretendon se KEK-u, përkundër provave të paraqitura nga ai, nuk ka shlyer borxhin paraprak që ka ekzistuar para blerjes së banesës nga ai në vitin 2009; nuk ka regjistruar njehsorin e energjisë elektrike në emër të tij edhe përkundër vendimit të ZRRE-së në favor të tij deri sa rasti ka shkuar në Gjykatën Themelore dhe, KEK-u ka mbajtur të shkyçur banesën e tij nga rrjeti elektrik përkundër faktit që borxhi për të cilin ngarkohej, nuk ishte i tij.
35. Si pasojë e këtyre shkeljeve, parashtruesi i kërkesës thekson se është detyruar që të shkëpusë kontratën mbi qiranë e banesës dhe të shesë banesën dhe shtëpinë e tij nën çmimin real të tregut, me ç'rast atij i janë shkaktuar dëme të pariparueshme materiale dhe jomateriale.
36. Lidhur me këtë, parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta nuk kanë vlerësuar mirë provat që ndërlidhen me vërtetimin e fakteve se KEK-u ka shkelur rregullat e brendshme kur ka nxjerrë vendim pas 3 (tre) vjetësh pas paraqitjes së ankesës edhe pse ka qenë e obliguar që të nxjerrë vendim brenda 3 (tre) muajve; ka anashkaluar çështjen e refuzimit nga KEK-u për të regjistruar njehsorin e energjisë elektrike në vitin 2009, dhe nuk ka vërtetuar mirë provat që dëshmojnë se parashtruesi i kërkesës ka qenë i shkyçur nga rrjeti elektrik si pasojë e borxhit të personave të tjerë për të cilin borxh ai nuk ka qenë përgjegjës, ashtu si është vërtetuar edhe me Vendimin e ZRRE-së në dobi të tij. Ai pretendon se nuk ka qenë i kyçur në rrjetin elektrik nga viti 2009, kur e ka blerë banesën dhe fatuarat e KEK-ut me të cilat gjykatat e rregullta kanë vërtetuar që ai ka qenë i kyçur në rrjet nga viti 2009, janë fatura paushalle dhe nuk vërtetojnë shpenzimin e energjisë elektrike nga ana e tij.
37. Parashtruesi i kërkesës po ashtu potencon se gjykatat e rregullta nuk kanë marrë parasysh ekspertizën e ekspertit që dëshmon se për shkak të shkyçjes së paligjshme nga rrejtë elektrik për borxhin e personave të tjerë, parashtruesi i kërkesës ka shitur banesën dhe shtëpinë nën çmimin real dhe është dashur të ndërpresë kontratën për qiranë e banesës e cila i siguronte një shumë të caktuar parash çdo muaj. Po ashtu, ai ankohet se dëshmitë e dëshmitarëve V. G. dhe P. M., janë "heshtur" nga gjykatat edhe pse ato vërtetojnë faktin që njehsori i rrymës që ka ekzistuar në vitin 2009 është konfiskuar nga KEK-u. Ai ankohet se përkundër këtyre shkeljeve, gjykatat e rregullta "*janë rreshtuar pas KEK-ut vazhdimisht, duke shtuar terrorin mbi mua dhe familjen time*".
38. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ankohet edhe lidhur me shpenzimet e procedurës, duke theksuar se ai "*ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës të*

cilat është dashur të njihen dhe pranohen” nga gjykatat e rregullta, por kjo kërkesë është refuzuar.

39. Parashkruesi i kërkesës, më tutje, pretendon shkelje të neneve 23 [Dinjiteti Njerëzor] dhe 24 [Barazia para Ligjit], duke theksuar se *“[...] KEK ka shkelur dinjitetin tim duke keqpërdorur monopolin që ka në raport me konsumatorin. Paligjshëm brutalisht gjatë viteve 2009, 2010, 2011 më ka shkyçur nga rrjeti energjetik banesën dhe në kërkim të një borxhi i cili nuk ishte imi për tre vite më ka lënë pa rrymë, duke më shkaktuar dëme të pariparueshme”.*
40. Lidhur me pretendimin për shkelje të të drejtës për barazi para ligjit, ai thekson se gjykatat e rregullta *“më kanë trajtuar në mënyrë të pabarabartë në raport me KEK-un sepse kanë shkelur prova dhe fakte të pakontestueshme në gjykim [...] gjyqtarët në tri nivele të gjyqësorit ndoshta lëngojnë nga logjika që po e mbrojnë një kompani publike”.*
41. Parashtruesi i kërkesës kërkon që të mos zbulohet identiteti i tij, duke arsyetuar që kërkon *“të ruhet privatësia e dy fëmijëve të mijë për të cilët po dorëzoj raporte medicinale. Nuk dua që në këtë fazë të bëhet publike shkelja e dinjitetit dhe integritetit që kam përjetuar për shkak të fëmijëve që i kam shumë të vegjël dhe nuk dua që të lëndohen”.*
42. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të *“njihet kërkesëpadia ime si korrekte”* dhe aktgjykimet e Gjykatës Themelore, të Apelit dhe Supreme të shpallen nule.

Pranueshmëria e kërkesës

43. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.
44. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

45. Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të kërkuara me nenet 47 [Kërkesat individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individit mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49
[Afat]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]”

46. Për sa i përket përmbushjes së kriterëve të mësipërme, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar; i ka shteruar mjetet juridike në dispozicion; e ka qartësuar aktin e autoritetit publik, kushtetutshmërinë e të cilit e konteston dhe të drejtat kushtetuese të cilat pretendon se i janë cenuar, si dhe e ka dorëzuar kërkesën në kohë.
47. Përveç kësaj, Gjykata gjithashtu duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Rregulli 39 (2) i Rregullores së punës përcakton që:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

48. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të të drejtave të tij kushtetuese, gjegjësisht të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (neni 31), të drejtës për mbrojtje të dinjitetit njerëzor (neni 23) dhe të drejtës për barazi para ligjit (neni 24).
49. Gjykata vëren se, lidhur me shkeljen e pretenduar të së drejtës së tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta nuk i kanë trajtuar në mënyrë të drejtë pretendimet e tij pasi nuk kanë vlerësuar si duhet provat e

paraqitura dhe dëshmitë e dëshmitarëve dhe ekspertit, lidhur me përgjegjësinë për dëmet që i janë shkaktuar parashtruesit nga kërkesa e paligjshme e KEK-ut që të paguajë borxhin e shfrytëzuesve të mëhershëm të banesës; mosfurnizimit apo shkyçjen e paligjshme nga rrjeti elektrik të banesës së parashtruesit të kërkesës për borxhin e shfrytëzuesve të mëhershëm të banesës, me ç'rast atij i është shkaktuar dëmi material dhe jomaterial, duke detyruar atë që të ndërpresë kontratën e qirasë për banesën, si dhe të shesë nën çmimin real banesën dhe shtëpinë e tij.

50. Lidhur me këto pretendime, Gjykata rikujton arsyetimin e Gjykatës Themelore, të Aktgjykimit C. nr. 2437/12 se:

“Nga lista e faturave me rrjedhën e energjisë së shpenzuar, rezulton se nga dt. 17.11.2009 e deri në muajin maj 2011, pika matëse në banesën e [parashtruesit të kërkesës] ka qenë e furnizuar me energji elektrike çka vërtetohet nga kjo pasqyrë e rrjedhjes së energjisë.

[...]

Gjykata ka gjetur se [parashtruesi i kërkesës] nuk ka paguar faturat e energjisë gjatë periudhës kohore sa ka qenë në posedim dhe shfrytëzim të banesës së tij respektivisht prej dt. 19.08.2009 gjer me 19.06.2011 edhe pse ka qenë i furnizuar me energji elektrike, në pasqyrën - transaksionet e konsumatorit vërehet se nuk është bërë asnjë pagesë. Gjykata ka gjetur se konsumatori [...] është shkyçur disa herë nga [KEK] për mospagesën e borxhit fillimisht të borxhit që ishte akumuluar edhe për paraardhësit - shfrytëzuesit e mëhershëm të banesës, mirëpo pas dt. së lartcekur është shkyçur edhe për mospagesën kur ai ishte posedues dhe shfrytëzues i banesës.

Gjykata ka gjetur se [KEK] me të drejtë dhe në bazë të nenit 6.1, 16.1 nën pika 1.1. dhe nenit 19 të rregullit për shkyçje dhe rikyçjen e konsumatorëve në Sektorin e Energjisë Elektrike në Kosovë, ka bërë shkyçjen e pikës furnizuese të [parashtruesit të kërkesës] pasi që [ai] nuk i është përmbajtur dinamikës-rregullit të pagesave sipas Rregullores së lartcekur.

Gjykata ka refuzuar pretendimet e [parashtruesit të kërkesës] për gjoja dëmin e shkaktuar nga ana e [KEK-ut] si pasojë e të cilit dëm [parashtruesi i kërkesës] ishte detyruar që të shesë banesën nën vlerën e çmimit të tregut, e po ashtu të prishë kontratën për dhënie të shtëpisë me qira [...] si dhe të shesë shtëpinë [...] nën çmimin e tregut [...]. Gjykata nuk e ka pranuar pretendimin e lartcekur [...], ngase vlerëson se në mes veprimeve të ndërmarra nga [KEK] dhe veprimeve të [parashtruesit të kërkesës] për shitjen e banesës, shtëpisë dhe prishjen e kontratës për qiranë [...] nuk ekziston asnjë lidhje kauzale .

[...]

[Parashtruesi i kërkesës] nuk ka arrit që t'a bindë gjykatën se ekziston lidhja kauzale në mes të veprimeve të [KEK-ut] dhe dëmit të shkaktuar në formë të fitimit të humbur e po ashtu as dëmit jomaterial të pretenduar sepse nuk ka ofruar asnjë provë materiale që do të argumentonte këto pretendime që kanë të bëjnë me dëmin jomaterial (zvogëlimin e aftësisë jetësore të paditësit, cenimin e autoritetit dhe shkeljen e të drejtave të njeriut.”

51. Gjithashtu, Gjykata e Apelit në tërësi i ka pranuar konstatimet faktike dhe qëndrimin juridik të Gjykatës Themelore, duke vlerësuar se ajo drejt ka vërtetuar gjendjen faktike dhe në mënyrë të drejtë e ka zbatuar të drejtën materiale kur ka gjetur se kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës është e pabazuar.
52. Në fund edhe Gjykata Supreme, në Aktgjykimin 78/2019, konstatoi:
“Parashtrimet në revizion se: aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është marrë me shkelje thelbësore të rregullave të procedurës kontestimore nga dispozita e nenit 194 të [Ligjit të Procedurës Kontestimore] LPK-së, cenimi thelbësor i rregullave të procedurës lidhur me mospërfilljes së ankesës së paditësit dhe mos përmbushjes së detyrimit që gjykata të vërtetojë në mënyrë të plotë të gjitha të dhënat me ndikim në gjykim të drejtë të fakteve vendimtare, [Gjykata Supreme] i vlerësoi dhe gjeti si të papranueshme pasi që Gjykata e shkallës së dytë në arsyetimin e aktgjykimit ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore dhe ka dhënë arsye të mjaftueshme për faktet relevante për gjykim të drejtë të kësaj çështjeje-juridike.”
53. Gjykata vëren se gjykatat e rregullta kanë vlerësuar faktet dhe kanë interpretuar dhe zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale në lidhje me kërkesën e parashtruesit të kërkesës. Konkluzionet e tyre u arritën pas ekzaminimit të hollësishëm të të gjitha argumenteve të paraqitura nga parashtruesi i kërkesës dhe e paditura..
54. Gjykata më tej vëren se parashtruesi i kërkesës përsërit para Gjykatës të njëjtat argumente që kishte parashtruar në procedurat pranë gjykatave të rregullta, në veçanti lidhur me vërtetimin e gjendjes faktike dhe ligjshmërisë së vendimeve të gjykatave të rregullta.
55. Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta gjatë vlerësimit të provave apo zbatimit të ligjit (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta që t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, rastin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ), *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, para. 28).
56. Roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm që të sigurojë respektimin e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe me instrumente të tjera ligjore. Për këtë arsye, Gjykata Kushtetuese nuk mund të veprojë si gjykatë e “shkallës së katërt” (shih, *mutatis mutandis*, Gjykata Kushtetuese, rasti KI86/11, parashtruesi i kërkesës: *Milaim Berisha*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 prillit 2012).

57. Gjykata më tej vëren se parashtruesi i kërkesës nuk pajtohet me rezultatin e procedurës para gjykatave të rregullta. Megjithatë, pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendim të argumentueshëm për shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (shih, *mutatis mutandis*, rastin *Mezotur - Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21; shih gjithashtu rastin KI56/17, parashtruese e kërkesës *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 42).
58. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në atë mënyrë dhe nëse procedurat në përgjithësi, shikuar në tërësinë e tyre, janë zhvilluar në mënyrë të tillë sa që parashtruesi i kësaj kërkeje të ketë pasur gjykim të drejtë (shih, *inter alia*, rasti *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, i miratuar më 10 korrik 1991).
59. Në lidhje me këtë, Gjykata konsideron se arsyetimi i dhënë nga gjykatat e rregullta, kur i referohen pretendimeve të parashtruesit për shkelje të ligjit procedural dhe material, është i qartë dhe i mjaftueshëm dhe se procedurat në gjykatat e rregullta nuk kanë qenë të padrejta apo arbitrare (shih, *mutatis mutandis*, rastin e GJEDNJ, *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, Aktgjykimi i 30 qershorit 2009).
60. Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se gjykatat e rregullta i kishin shkelur të drejtën e tij për barazi para ligjit të garantuar me nenin 24 të Kushtetutës dhe dinjitetin njerëzor të garantuar me nenin 23 të Kushtetutës.
61. Në lidhje me të drejtën për barazi para ligjit, Gjykata rikujton që trajtimi është diskriminues nëse një individ trajtohet ndryshe nga të tjerët në pozita ose situata të njëjta apo të ngjashme dhe nëse ky ndryshim në trajtim nuk ka ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm.
62. Gjykata përsërit se trajtimi i ndryshëm duhet të ndjekë një qëllim legjitim për të qenë i justifikuar dhe duhet të ketë një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti, midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet të arrihet (shih rastin e GJEDNJ, *Marckx kundër Belgjikës*, Kërkesa nr. 6833/74, Aktgjykimi i 13 qershorit 1979, paragrafi 33).
63. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie* dhe as nuk e ka mbështetur pretendimin që tregon se ai ishte diskriminuar në procedurat në gjykatat e rregullta.
64. Gjithashtu, lidhur me dinjitetin njerëzor të mbrojtur me nenin 23 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës, përveç që thekson se “KEK-u ka shkelur dinjitetin tim duke keqpërdorur monopolin që ka në raport me konsumatorët” nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi dhe as nuk e ka mbështetur pretendimin.

65. Si përmbledhje, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur fakte që tregojnë se procedurat në gjykatat e rregullta, në ndonjë mënyrë, kanë shkaktuar shkelje kushtetuese të të drejtave të tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të dinjitetit njerëzor dhe të barazisë para ligjit.
66. Rrjedhimisht, Gjykata vjen në përfundim se kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

Kërkesa për moszbulim të identitetit

67. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës kishte kërkuar që identiteti i tij të mos zbulohet publikisht, duke kërkuar *“të ruhet privatësia e dy fëmijëve të mijë për të cilët po dorëzoj raporte medicinale. Nuk dua që në këtë fazë të bëhet publike shkelja e dinjitetit dhe integritetit që kam përjetuar për shkak të fëmijëve që i kam shumë të vegjël dhe nuk dua që të lëndohen”*.
68. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet rregullit 32 (6) të Rregullores së punës, i cili përcakton:
- “Palët në kërkesë që nuk dëshirojnë që identiteti i tyre të zbulohet në publik, duhet të tregojnë arsyet që justifikojnë një largim të tillë nga rregulli i qasjes publike në informata në procedurën në Gjykatë. [...].”*
69. Megjithatë, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka treguar dhe paraqitur dëshmi të mjaftueshme me të cilat do të kishte arsyetuar kërkesën e tij për moszbulimin e identitetit të tij dhe, rrjedhimisht, kjo kërkesë e parashtruesit hidhet poshtë si e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 20 të Ligjit dhe në pajtim me rregullat 32 (6) dhe 39 (2) të Rregullores së punës, më 7 nëntor 2019, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TË REFUZOJË kërkesën për moszbulim të identitetit;
- III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- IV. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Bekim Sejdiu



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi